

**Përgjigje ndaj kërkesës për informacion – nr. prot. 2143, datë 19.09.2025**

E nderuar znj.

Në vijim të email-it tuaj të datës 25.08.2025 (i cili është regjistruar si spam në postën elektronike të institucionit tonë), si dhe të email-it tuaj të datës 19.09.2025, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë me nr. 2143, datë 19.09.2025, "Kërkesë për informacion", ju informojmë si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nuk ka të përcaktuara në aktet e saj ligjore dhe nënligjore detyrimet për deklarimin e përmbajtjes reale të metaleve të çmuara nga importuesit. Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se në Republikën e Shqipërisë nuk është ende e ngritur një strukturë "Assay Office", ashtu siç ju referoheni në komunikimin tuaj.

Gjithashtu, theksojmë se kontrolli dhe certifikimi i metaleve të çmuara nuk bën pjesë aktualisht në objektin e punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Ju faleminderit.

Me respekt,